


Monitorimi dhe vlerësimi qytetar mbi menaxhimin e mbetjeve urbane në zonën e Ish-Kënetës – Durrësi i Ri



Hartuar nga:
Rrjeti i Qendrave për Zhvillim Komunitar
SOT PËR TË ARDHMEN





Ky raport është produkt i projektit “Monitorim, vlerësim, ndërgjegjësim mbi menaxhimin e mbetjeve urbane në zonën e Ish-Kënetë – Durrës i Ri” që zbatohet nga organizata Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”, në kuadër të programit ACHIEVE “Shoqëria Civile Shqiptare për një Mjedis Evropian” i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit, Shqipëri (REC).

Grupi i punës:

Fabiola Laço Egro, Drejtore Ekzekutive QZHK “Sot për të Ardhmen”

Iva Qehaja

Manjola Stefani

Arjola Hoxha

Rudina Copa

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian apo dhe të REC Shqipëri



BASHKIMI EVROPIAN
DELEGACIONI NË SHQIPËRI

*Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian*

ACHIEVE
shoqëria civile shqiptare për një mjedis evropian

 **REC**
Shqipëri

Monitorimi dhe vlerësimi qytetar mbi menaxhimin e mbetjeve urbane në zonën e Ish-Kënetës – Durrësi i Ri



Ky projekt zbatohet nga:
Rrjeti i Qendrave për Zhvillim Komunitar
SOT PËR TË ARDHMEN



Hyrje

Bashkia Durrës gjatë 20 viteve të fundit ka qenë subjekt i një transformimi të thellë urban, i cili ka ndryshuar strukturën e tokës në hapësirë, dendësi, larmi funksionesh dhe pabarazi të theksuara në qasje shërbimesh.

Sot vendgrumbullimi i Porto Romanos është i vetmi vend asgjësimi që përdoret në Durrës. Ai është komplet i amortizuar, me rrezik shumë të lartë ndotjeje dhe ishte parashikuar të mbyllej në vitin 2015.

Qeveria në nivel kombëtar ka planifikuar ndërtimin e venddepozitimit të mbetjeve në Manzë. Që në fund të vitit 2014, Ministria e Mjedisit nisi procedurën e dhënies me koncesion të landfillit për qarkun e Durrësit, referuar nenit 48 të ligjit 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat” në Radë, Manës, ende e porealizuar.

Ofrimi i shërbimeve publike nga Bashkia Durrës nuk kryhet në funksion të densitetit të banesave dhe lidhur me mbetjet, kjo pasqyrohet me mungesën e kontenierëve të mjaftueshëm për grumbullimin e tyre në çdo lagje (sidomos në zonën e ish-Kënetës numri i kontenierëve është shumë i pakët).

Në asnjë vend në qytet nuk bëhet diferencimi i mbetjeve që në burim. Riciklimi i mbetjeve është i kufizuar dhe i pakonsoliduar.

Ndërkohë Bashkia Durrës në Strategjinë e Zhvillimit të Territorit ka të miratuara si pjesë e Planit të Investimeve

Kapitale dhe Programit Buxhetor 2016-2018, programe dhe projekte për përmirësimin e menaxhimit të mbledhjes së mbetjeve urbane, transportimit të tyre dhe riciklimit, por nuk ka asnjë buxhet të miratuar në vlerë monetare dhe të deklaruar për këtë qëllim.

Mungesa e venddepozitimeve të përshtatshme në të gjithë qytetin, ndërkohë që sasia e mbetjeve të ngurta është në rritje, mbetet një nga sfidat dhe çështjet që duhet të marrin përparësi në planet vendore dhe buxhetimin përkatës të Bashkisë Durrës.

Ish-Këneta ose e quajtur Durrësi i Ri, me strategjinë vendore është planifikuar të ketë investime në industri duke nxitur zhvillimin ekonomik. Kjo zonë me rreth 60,000 banorë, dhe me përbërje 95% popullsi migratore, mbulohet nga dy NJQV, përkatësisht nr. 5 dhe 6, me mungesë të theksuar në shërbime publike, në infrastrukturë e rrjete, të cilat shkaktojnë probleme madhore mjedisore.

Në lidhje me mbetjet urbane mungojnë standardet në menaxhim dhe monitorim. Tërësia e veprimtarisë konsiston kryesisht në shërbimet e mbledhjes, transportit dhe depozitimit me një mbulim territorial vetëm në rrugët kryesore, ndërkohë që disa aspekte të menaxhimit kanë shkallë të ulët si: masat për edukimin mjedisor dhe politikave vendore për ndërgjegjësim qytetar, kurse aspekte të tjera si: ripërdorimi, riciklimi, ndarja janë inekzistente.

Gjithashtu për shkak të largësisë së kësaj zone nga qendra e qytetit, evadimi i mbetjeve nga vendgrumbullimi në komunitet kryhet në frekuenca kohe më të rralla se sa është

në të vërtetë nevoja. Ky problem i kthen vendmbledhjet në burim ndotje për të gjithë komunitetin që banon në zonë.

Ndërkohë kontenerët janë të vendosur buzë rrugës kryesore ndërsa brenda në lagje nuk ekzistojnë kontenerë në pjesën dërrmuese të territorit. Kështu, banorët që jetojnë pranë rrugës e kanë kontenerin në një distancë prej 50 m larg, ndërsa ata që banojnë në pjesën fundore të kanalit e kanë rreth 800 m larg. Pra mesatarisht, kontenerët e grumbullimit të mbetjeve ndodhen rreth 350m larg për banor në këtë zonë.

Ky raport ka për qëllim të paraqesë opinionin qytetar mbi menaxhimin e shërbimeve të mbetjeve në zonën e Ish-Kënetës në Durrës.

Rezultatet e paraqitura janë përpunuar nga të dhënat cilësore dhe sasiore të përfituara nga anketimi në terren dhe monitorimi i drejtpërdrejtë i shërbimeve të mbetjeve urbane si: depozitimi, largimi, koha dhe frekuenca e shërbimit, mbulimi territorial dhe cilësia e shërbimit.

Metodologjia e përdorur është fokusuar në intervistimin e drejtpërdrejtë të një kampioni prej 100 banorësh në mënyrë rastësore, por me mbulim të të gjithë territorit të zonës së Ish-Kënetës dhe paralelisht me monitorim të drejtpërdrejtë të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve nga grupi i vullnetarëve të Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”.



Tabela e Përmbajtjes

Hartëzimi i depozitimit të mbetjeve.....	7
Dendësia e popullimit në lagje dhe rrugë.....	8
Shpeshhtësia e depozitimit të mbetjeve nga familjet.....	8
Tipologjia e mbetjeve të depozituara nga banorët.....	9
Depozitimi i mbetjeve nga banorët.....	9
Tarifimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve.....	10
Hartëzimi i vendgrumbullimeve sipas qytetarëve.....	11
Tipologjia dhe shpërndarja e vendgrumbullimeve të mbetjeve.....	12
Situata aktuale në territor sipas qytetarëve.....	13
Vlerësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve nga qytetarët.....	14
Shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbetjeve.....	15
Ofrimi i shërbimit të largimit të mbetjeve.....	15
Frekuenca dhe mbulimi i shërbimit të largimit të mbetjeve.....	15
Shërbimi i pastrimit të rrugëve.....	15
Shërbimi i largimit të mbetjeve inerte.....	16
Shërbimi i pastrimit të kanaleve.....	17
Problemet emergjente dhe niveli i përgjithshëm i shërbimit sipas opinionit qytetar.....	18
Vlerësimi i nivelit të përgjithshëm të shërbimit sipas opinionit qytetar.....	20
Përmbledhje të gjetjeve kryesore dhe Rekomandime.....	22



**Hartëzimi i depozitimit
të mbetjeve**



Dendësia e popullimit në lagje dhe rrugë

Të pyetur për numrin e familjeve që banojnë në rrugët përkatëse (*grafiku 1*), 96% e të anketuarve kanë dhënë përgjigje duke iu referuar një numri që varion nga 10 deri në 40 familje për rrugë, pra mesatarisht rreth **25 familje/ rrugë**.




Shpeshtësia e depozitimit të mbetjeve nga familjet

Nisur dhe nga të dhënat më poshtë: 50% e familjeve ose 1 në 2 familje depozitojnë mbetje çdo ditë.

Në lidhje me shpeshtësinë e depozitimit të mbetjeve (*grafiku 2*), 42% e të anketuarve i depozitojnë një herë në ditë, 27% një herë në dy-tre ditë, 17% një herë në javë, 8% disa herë në ditë dhe 6% janë pa përgjigje.


Dendësia e popullimit për rrugë



(*grafiku 1*)

Shpeshtësia e depozitimit

- Disa herë në ditë
- Një herë në ditë
- Një herë në 2 - 3 ditë
- Një herë në javë
- Nuk e di
- Pa përgjigje



(*grafiku 2*)



Tipologjia e mbetjeve të depozituara nga banorët

Në lidhje me tipin e mbetjeve të depozituara (grafiku 3), 52% e të anketuarve janë përgjigjur se depozitojnë kryesisht mbetje shtëpiake, 42% mbetje të përziera dhe 2% janë pa përgjigje.



Depozitimi i mbetjeve nga banorët


Në lidhje me depozitimin e mbetjeve nga qytetarët, të anketuarit u pyetën në dy mënyra:

- a) ku i hedhin ata mbeturinat dhe,
- b) si mendojnë ata për qytetarët në përgjithësi, a i hedhin mbeturinat në vendet e caktuara?


Vihet re se 73% e të anketuarve janë përgjigjur se i hedhin mbetjet në kontenerët e caktuar, por kur përgjigjen për opinionin që kanë, nëse qytetarët i hedhin mbetjet në vendet e caktuara, vetëm 54% janë përgjigjur "Po" dhe "Në të shumtën e rasteve po". Vihet re një diferencë e konsiderueshme (25%) midis pohimit personal dhe opinionit mbi veprimet e të tjerëve. Shih (grafiku 4) dhe (grafiku 5).

Mbetjet e depozituara

- Shtëpiake
- Inerte
- Perzier
- nuk e di
- pa përgjigje



(grafiku 3)



Kryerja e depozitimit të mbetjeve sipas vend grumbullimit nga të anketuarit

(grafiku 4)

Duke qenë se 100 të anketuarit janë përzjedhur në mënyrë rastësore, kjo diferencë tregon se është e domosdoshme thellimi i ndërgjegjësimit qytetar për hedhjen e mbeturinave në vendet e caktuara, dhe së dyti, presioni ndaj shërbimeve të bashkisë për shtimin e kontenerëve në zonën e ish-kënetës.





Tarifimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve

Në lidhje me pagesat e tarifave të pastrimit (grafiku 6), 75% e të anketuarve janë përgjigjur se paguajnë tarifat e pastrimit, 13% janë përgjigjur që nuk e dinë, dhe 2% nuk janë përgjigjur, ndërsa 10% e të anketuarve janë shprehur që nuk paguajnë tarifë pastrimi.



Në lidhje me opinionin për vlerën e tarifimit të pastrimit (grafiku 7), 60% e të anketuarve janë përgjigjur se tarifa është e përballueshme apo nuk përbën problem dhe 21% e tyre janë shprehur se nuk mund ta paguajnë. Ndërsa 19% janë pa përgjigje, ose janë shprehur se nuk e dinë.

Opinionin e të anketuarve mbi kryerjen e depozitimit të mbetjeve sipas vend grumbullimit nga qytetarët





(grafiku 5)

Pagesa e tarifave të pastrimit



(grafiku 6)

Opinionin mbi vlerën e tarifimit të pastrimit



(grafiku 7)









**Hartëzimi i vendgrumbullimeve
sipas qytetarëve**

Tipologjia dhe shpërndarja e vendgrumbulli meve të mbetjeve

Në lidhje me vendosjen dhe shpërndarjen e kontenierëve dhe situata në lidhje me hedhjen e mbetjeve nga qytetarët vihet re se kontenierët janë të vendosur kryesisht në rrugët kryesore në masën 40%, kurse në masën 30% janë 1 deri në 2 kontenierë për lagje. Vendet e hapura ku hidhen mbetjet zënë rreth 46% të rasteve. (hedhjet e mbetjeve në vende të hapura dhe jo në vendgrumbullim të caktuar ndodh rëndom në rrugët e lagjeve). Përsa i përket kontenierëve të diferencuar përbëjnë vetëm 6%. Shih (tabelën 1) dhe (tabelën 2).








Situata e kontenierëve sipas të anketuarve

Kontenierë	1-2 në rrugën e lagjes		30%
	3-4 në rrugën e lagjes		6%
	>4 në rrugën e lagjes		4%
	në rrugën kryesore		40%
Të diferencuar	Po		6%
	Jo		94%

(tabela 1)

Situata e vendeve të betonizuara/ vende të hapura sipas të anketuarve

Vende të betonizuara	1-2 në rrugën e lagjes		10%
	3-4 në rrugën e lagjes		2%
	>4 në rrugën e lagjes		2%
	në rrugën kryesore		60%
Vende të hapura		46%	

(tabela 2)



Situata aktuale në territor sipas qytetarëve

Situata në rrugët dhe lagjet e ish- Kënetës përshkruhet sa më poshtë nga të anketuarit (tabela 3):

Kurse në lidhje me disinsektimin, disinsektimin dhe deratizimin e vendmbledhjeit të mbetjeve, të anketuarit kanë dhënë këto përgjigje (tabela 4):



Situata në rrugët/lagjet në lidhje me:

Plehra në rrugë	Gjithnjë - Shpesh	65%
	Ndonjëherë - Rrallë	25%
Erë e rëndë	Gjithnjë - Shpesh	40%
	Ndonjëherë - Rrallë	35%
Insekte/Miza/mushkonja	Gjithnjë - Shpesh	88%
	Ndonjëherë - Rrallë	8%
Brejtës/minj	Gjithnjë - Shpesh	44%
	Ndonjëherë - Rrallë	42%
Qen rruge	Gjithnjë - Shpesh	81%
	Ndonjëherë - Rrallë	13%

(tabela 3)

Situata në rrugët/lagjet në lidhje me:

Pastrimi i vend-grumbullimit	Gjithnjë - Shpesh	33%
	Ndonjëherë - Rrallë	38%
Disinsektimi i vend-grumbullimit	Gjithnjë - Shpesh	8%
	Ndonjëherë - Rrallë	38%
Zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve	Gjithnjë - Shpesh	38%
	Ndonjëherë - Rrallë	33%
Aksion tjetër disinsektimi, deratizimi	Gjithnjë - Shpesh	6%
	Ndonjëherë - Rrallë	42%

(tabela 4)



**Vlerësimi i shërbimit të menaxhimit
të mbetjeve nga qytetarët**



Shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbetjeve

Ofrimi i shërbimit të largimit të mbetjeve

Në lidhje me ofrimin e shërbimit të largimit të mbetjeve, të anketuarit shprehen se në Ndërmarrja Komunale mbulon 62% të shërbimit, kurse 19% të shërbimit mbulohet nga vetë banorët. 17% e të anketuarve nuk e dinë se nga bëhet ky shërbim. Shih (grafiku 8).

Frekuenca dhe mbulimi i shërbimit të largimit të mbetjeve

Në lidhje me shpeshtësinë e largimit të mbetjeve, 38% e të anketuarve u shprehën se realizohet vetëm në rrugën kryesore dhe 19% e tyre shprehen se realizohet 1 herë në javë, dhe 19% 1 herë në ditë, kurse 10% shprehen se i djegin në vend. Shih (grafiku 9).




Shërbimi i pastrimit të rrugëve

Të anketuarit u pyetën në lidhje me pastrimin e rrugëve. Në lidhje me shpeshtinë e pastrimit të rrugëve përgjigjet e tyre janë se rrugët pastrohen:


- “Gjithnjë” dhe “shpesh” në 38% të rasteve, ku 34% nga qytetarët dhe 4% nga bashkia.

Grumbullimi dhe largimi i mbetjeve



(grafiku 8)

Grumbullimi dhe largimi i mbetjeve



(grafiku 9)

- “Ndonjëherë” dhe “rrallë” në 27% të rasteve, ku qytetarët dhe bashkia konsiderohen njësoj në angazhim
- “Asnjëherë” dhe “pa përgjigje”, apo “nuk e di”, përbëjnë 35% të përgjigjeve në total.

Shih (grafiku 10).

Megjithatë, të pyetur nëse arsyet e mospastrimit janë të lidhura dhe me gjendjen dhe vendodhjen e rrugëve, qytetarët janë shprehur se në 60% të rasteve rrugët nuk pastrohen, pasi janë të paasfaltuar.





Shërbimi i largimit të mbetjeve inerte

Të anketuarit u pyetën në lidhje me largimin e mbetjeve inerte dhe dhanë këto përgjigje:

- “Gjithnjë” dhe “shpesh” në 20% të rasteve, ku 15% nga qytetarët dhe 5% nga bashkia.
- “Ndonjëherë” dhe “rrallë” në 27% të rasteve, ku 18% nga qytetarët dhe 9% nga bashkia.
- “Asnjëherë” dhe “pa përgjigje”, apo “nuk e di”, përbëjnë 53% të përgjigjeve në total.

Shih (grafiku 11).





Shërbimi i pastrimit të kanaleve

Të anketuarit u pyetën në lidhje me pastrimin e kanaleve dhe dhanë këto përgjigje:

- “Gjithnjë” dhe “shpesh” në 16% të rasteve, ku 9% nga qytetarët dhe 7% nga bashkia.
- “Ndonjëherë” dhe “rrallë” në 27% të rasteve, ku 13% nga qytetarët dhe 14% nga bashkia.
- “Asnjëherë”, “pa përgjigje” dhe “nuk e di” përbëjnë 57% të përgjigjeve në total. shih (grafiku 12).

Vihet re se në pjesën më të madhe të rasteve, shërbimet e pastrimit të territorit konsistojnë në evadimin e mbetjeve të grumbulluara.


Kështu, pastrimi i rrugëve është në masën:

- 65% që varion 38% gjithnjë dhe shpesh, dhe 27% ndonjëherë dhe rrallë, kurse kur bëhet fjalë për shërbime si largimi i dherave, apo pastrimi i kanaleve, ato janë respektivisht në masën:
- 47% largimi i dherave që varion 20% gjithnjë dhe shpesh, dhe 27% ndonjëherë dhe rrallë, dhe
- 43% pastrimi i kanaleve që varion 16% gjithnjë dhe shpesh dhe 27% ndonjëherë dhe rrallë.

Për më tepër, largimi i dherave (apo mbetjeve inerte) dhe

pastrimi i kanaleve bëhet përgjithësisht në zonat ku janë vendosur pikat e grumbullimit të mbetjeve (kryesisht me vende të hapura 46% - *tabela 2*).

Më tej, ka një korelacion të drejtë midis rrugëve kryesore (38% e të anketuarve u shprehën se largimi i mbetjeve realizohet vetëm në rrugën kryesore – *grafiku 10*), rrugëve të asfaltuara (40%) dhe vendodhjes së kontenerëve me pastrimin në tërësi (40% të vendosur në rrugët kryesore *tabela 1*).



(grafiku 12)



Problemet emergjente dhe niveli i përgjithshëm i shërbimit sipas opinionit qytetar

Qytetarët kanë listuar problematikat kryesore dhe në lidhje me to kanë detajuar çështjet emergjente për t'u trajtuar nga Bashkia Durrës. (tabela 5)

Ndër problematikat kryesore në lidhje me ofrimin e shërbimit të grumbullimit dhe largimit të mbetjeve, ata kanë listuar si kryesore:

1. Cilësinë e shërbimit 96% ku kanë detajuar:

- a) kushtet higjeno-sanitare të vendgrumbullimeve (disinfektimi, disinsektimi, deratizimi)
- b) shpeshtësia e shërbimit (orare më të shpeshta të largimit të mbetjeve)
- c) kryerja e shërbimit (zbrazja e kontenierëve, grumbullimi dhe largimi i mbetjeve jashtë kontenierëve, apo në vend grumbullime betoni dhe vende të hapura)


2. Shtimi i numrit të kontenierëve 80% ku kanë detajuar:

- a) në 1 ndër 2 raste, kërkohet vendosja e kontenierëve, pasi mungojnë, sidomos në rrugët e brendshme
- b) dhe në 1 ndër 3 raste, kërkohet shtimi i kontenierëve në rrugët ku ekzistojnë, pasi janë të vendosur shumë larg njëri tjetrit.

3. 1 ndër 4 qytetarë kanë prekur dhe tarifimin, ku në shumicën e rasteve të përmendura (afërsisht 70% e tyre), shihet si një shërbim që nuk i përgjigjet pagesës së kryer, dhe një pjesë e vogël e shohin më tej, dhe si pagesë të lartë)

(tabela 5)

Problematika kryesore	%	Në brendësi	%
Cilësia e shërbimit	96%	Kushtet higjeno-sanitare të vend-grumbullimeve	45%
		Shpeshtësia e shërbimit	26%
		Kryerja e shërbimit	25%
Plotësimi me Kontenierë	80%	Nuk ka kontenierë	49%
		Nuk ka mjaftueshëm kontenierë	31%
Tarifimi	25%	Pastrimi nuk i përgjigjet tarifës së pastrimit	17%
		Tarifa e pastrimit është e papërbalueshme	8%



Ky nuk është
mjedisi ku dua të
jetoj

**Vlerësimi i nivelit të përgjithshëm
të shërbimit sipas opinionit qytetar**

Duke marrë këtë renditje të problematikave kryesore të shprehura, qytetarët kanë dhënë dhe mendimin e tyre të përgjithshëm mbi nivelin e shërbimit të grumbullimit dhe largimit të mbetjeve.

Vihet re se 69% e qytetarëve janë të pakënaqur në përgjithësi nga niveli i shërbimit, 23% shprehen se janë deri diku të kënaqur, dhe vetëm 4% shprehen se janë të kënaqur. Po kaq (4%) janë pa përgjigje. Ndërkohë nuk ka asnjë përgjigje për “shumë të kënaqur” apo “Nuk e di”.


Shih (grafiku 13).

ë pyetur nëse do të ishin të gatshëm të ndanin mbeturinat, nëse do të shtohesh numri i kontenerëve të diferencuar dhe nëse do të ishin të gatshëm të merrnin pjesë në fushata të ndërgjegjësimit dhe të riciklimit, 92% e të anketuarve janë për ndarje të mbeturinave dhe 86% janë për pjesëmarrje në fushata ndërgjegjësimit dhe riciklimi.

Shih (grafiku 14) dhe (grafiku 15).


Opinionii qytetar mbi shërbimin në tërësi

- Shumë të kënaqur
- Të kënaqur
- Deri diku të kënaqur
- Aspak të kënaqur
- Nuk e di
- Pa përgjigje




(grafiku 13)

Gatishmëria qytetare në pjesëmarrje të fushatave të ndërgjegjësimit dhe të riciklimit



(grafiku 14)

Gatishmëria qytetare në depozitim të mbeturinave të ndryshme



(grafiku 15)



Përmbledhje të gjetjeve kryesore dhe Rekomandime

Përmbledhje të gjetjeve kryesore

Statistikë:

Mesatarisht, një familje në qytetin e Durrësit prodhon rreth 2 ton mbetje në vit ose 5.5 **kg mbetje në ditë**. Në Bashkinë e Durrës nuk ka grumbullim të diferencuar të mbeturinave për mbeturinat e zakonshme dhe të ndërtimit. Gjithashtu, nuk është vendosur asnjë kufizim kohor për depozitimin e mbeturinave nga banorët. Pasi kryhet mbledhja e mbeturinave, hidhen në vend depozitimit ekzistuese në zonën e Kënetës dhe digjen pa masa paraprake. Kjo është një procedurë e dëmshme për shkak të emetimit të gazit helmues, si dhe përbën rrezikshmëri të lartë për ndotjen e ujërave nëntokësore¹.

Gjetje:

- Popullimi i rrugëve është 10 deri në 40 familje për rrugë, pra mesatarisht rreth **25 familje/ rrugë**.
- 50% e familjeve ose **1 në 2 familje depozitojnë mbetje çdo ditë**. 52% mbetje shtëpiake, 42% mbetje të përziera dhe 2% inerte.

Statistikë:

Në zonën e Ish-Kënetës janë 54 Kontenierë. Kontenierët janë

¹ Strategjia e Zhvillimit Territorial 2015 – 2030, Aneksi 2 – Analiza dhe Vlerësimi i Territorit, Shkurt 2016

të vendosur buzë rrugës kryesore, ndërsa brenda në lagje nuk ekzistojnë kontenierë në pjesën dërrmuese të territorit. Kështu banorët që jetojnë pranë rrugës e kanë kontenierin në një distancë prej 50 m larg, ndërsa ata që banojnë në pjesën fundore të kanalit e kanë rreth 800 m larg. Pra mesatarisht, kontenierët e grumbullimit të mbetjeve ndodhen rreth 350m larg për banor në këtë zonë.

Gjetje:

- **Në rreth 1 nga 2 raste mbetjet hidhen në kontenierë.** (Rreth 19% e banorëve pranojnë se i hedhin mbetjet ku të munden, kryesisht në kanal. 73% e të anketuarve janë përgjigjur se vetë i hedhin mbetjet në vendet e caktuara, por kur japin mendimin për sjelljen e qytetarëve në zonë, vetëm 54% janë përgjigjur “Po” dhe “Në të shumtën e rasteve po”.)
- Kontenierët janë të vendosur kryesisht në rrugët kryesore në masën 40%, kurse në masën 30% janë 1 deri në 2 kontenierë për lagje.
- Vendet e hapura ku hidhen mbetjet zënë rreth 46% të rasteve.

Statistikë:

Gjatë vitit 2016, mesatarisht për çdo ditë janë evaduar për tu depozituar pranë vend grumbullimit të mbetjeve Porto Romano, rreth 148 m³/ditë mbetje urbane, dhera inerte etj, ose 104 ton në ditë për qytetin e Durrësit (Nuk ka të dhëna të diferencuara për zonën e Ish-Kënetës).

Gjetje:

- Sipas të anketuarve, në 38% të rasteve evadimi i mbetjeve bëhet vetëm në rrugët kryesore, që është në korelacion të drejtë me vendosjen e kontenierëve. *(Kurse në rastet e tjera: në 6% kryhet 2 herë në ditë (zonë kryesore pranë qytetit) 19% të rasteve kryhet 1 herë në ditë, 4% në 2-3 ditë dhe 19% e tyre shprehen se realizohet 1 herë në javë, 10% shprehen se i djegin në vend.)*

Statistikë:

Gjatë vitit 2016, u vendosën mbi 400 rrota kontenierësh dhe janë lyer me bojë mbi 200 kontenierë në të dy zonat e pastrimit; është përdorur 41.700 kg gëlqere të pashuar, 80 kg klor pluhur dhe 80 kg klor të lëngshëm për dezinfektimin e vendgrumbullimit të mbetjeve, kontenierëve dhe mjeteve të transportit; si dhe janë larë disa herë në muaj kontenierët dhe vendi i tyre, kryesisht në zonën turistike të qytetit. (Nuk ka të dhëna të diferencuara për zonën e Ish-Kënetës).

Gjetje:

- Sipas të anketuarve, pastrimi i vendgrumbullimit të mbetjeve kryhet në masën 33%, disinfektimi 8%, zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve në masën 38% .

Statistikë:

Gjatë vitit 2016, për çdo ditë në qytet, pastrohet nga

Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës rreth 1.094.000 m² gjatë tre turneve të shërbimit, që në raport me vitin 2015, është 33.000 m² më pak për çdo ditë.

Gjetje:

- Sipas të anketuarve Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës mbulon 62% të shërbimit; rrugët pastrohen në 38% të rasteve, largimi i inerteve/dherave në 20% të rasteve dhe pastrimi i kanaleve në 16% të rasteve. (Përgjithësisht, largimi i mbetjeve inerte/dherave dhe pastrimi i kanaleve bëhet në zonat ku janë mbetje të hedhura në vende të hapura).

Statistikë:

Gjatë vitit 2016, Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës ka kryer sipas rregullores dizinfektimin, dizinsektimin dhe deratizimin sipas fazave të zhvillimit të insekteve, mushkonjave, dhe luftimin e brejtëseve të ndryshëm (kryesisht në ndërtesa dhe objekte publike si çerdhe dhe kopshte). (Nuk ka të dhëna të diferencuara për zonën e Ish-Kënetës).

Gjetje:

- Sipas të anketuarve, situata paraqitet: plehra në rrugë 65% të rasteve, erë e rëndë 40% të rasteve, insekte (mushkonja, miza etj.) në 88% të rasteve, brejtës në 44% të rasteve, qen rruge në 81% të rasteve)

Probleme të evidentuara për marrjen e masave urgjente:

1. Cilësia e shërbimit është kërkuar në nivelin 96%, ku kanë detajuar:

- a) kushtet higjieno-sanitare të vëndgrumbullimeve (disinfektimi, disinsektimin, deratizimi)
- b) shpeshtësia e shërbimit (orare më të shpeshta të largimit të mbetjeve)
- c) kryerja e shërbimit (zbrazja e kontenierëve, grumbullimi dhe largimi i mbetjeve jashtë kontenierëve apo në vënd grumbullime betoni dhe vende të hapura)

2. Shtimi i numrit të kontenierëve është kërkuar në nivelin 80%, ku kanë detajuar:

- a) 1 ndër 2 raste kërkohe vendosja e kontenierëve, pasi mungojnë, sidomos në rrugët e brendshme
- b) 1 ndër 3 raste kërkohe shtimi i kontenierëve në rrugët ku ekzistojnë, pasi janë të vendosur shumë larg njëri - tjetrit.

3. 1 ndër 4 qytetarë kanë prekur dhe tarifimin, ku në shumicën e rasteve të përmendura (afërsisht 70% e tyre), shihet si një shërbim që nuk i përgjigjet pagesës së kryer, dhe më tej, një pjesë e vogël e shohin dhe si pagesë të lartë)

Rekomandime Parantezë

Planet Kombëtare të Zhvillimit të Territorit që gjejnë zbatim në Durrës, janë Plani i Përgjithshëm Kombëtar, Plani i Integruar Ndërsektorial dhe Durana.

Planifikimi territorial i Durrësit duhet të orientohet nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar, i cili cilëson menaxhimin e mbetjeve drejt një cikli të mbyllur.

Plani i Integruar Ndërsektorial për zonën bregdetare duhet të garantojë integrimin e politikave territoriale, në funksion të ndërtimit të një rajoni të zhvilluar ekonomikisht, e kështu ai indikon zonat e mbrojtura mjedisore, ku në kuadrin e ndotjes së lumenjve në afërsi të bregut për qytetin e Durrësit cilëson: *“Në qytetet bregdetare është e rëndësishme të ndërtohen landfille dhe qendra për përpunimin e mbetjeve, pasi ndotja është një nga arsyet kryesore që sjell rënien e popullimit të plazheve në Durrës”. Por PINS nuk e përmend Durrësin në kapitullin e turizmit.*

Plani i Integruar Ndërsektorial për Duranën thekson rëndësinë e furnizimit me ujë, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe ndërtimin e strategjisë për menaxhimin e përmbytjeve.

Koncepti i mbetjes prek te gjitha flukset e përcaktuara për Bashkinë Durrës: çdo mall apo shërbim që nuk riciklohet apo përdoret në mënyrë eficiente, konsiderohet “mbetje”. Menaxhimi i mbetjeve të ngurta ka kostot më të larta për buxhetin vendor. Bashkia duhet të shërbejë si platformë shkëmbimi ku bëhet përpunimi i mbetjeve urbane (në ujë, energji, mbetje industriale, materiale konsumi etj), me qëllim transformimin e tyre në lëndë të para.

Për të arritur një manaxhimm të mirë të mbetjeve urbane fillimisht është i nevojshëm të hartohet menjëherë plani imanaxhimit të mbetjeve urbane për Bashkinë Durrës me një vizion të qartë dhe indikatorë të përcaktuar, pas analizimit të sasive dhe përmbajtjes së mbetjeve që gjenerohen në rajonin Durrës. Ky plan duhet të marrë parasysh rekomandimet sa më poshtë, që prekin dhe zonën e Ish-Kënetës, të nxjerra nga monitorimi dhe vlerësimi qytetar:

Grumbullimi

1. Rritja e investimeve në përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe infrastrukturës për manaxhimin e trupave ujorë, në mënyrë që të mos krijohen venddepozitime anë rrugëve dhe në shtratet e trupave ujorë.
2. Shtimi i numrit të kontenierëve të mbeturinave pranë zonave të banuara, duke shkurtuar distancën që duhet të përshkojë një banor nga shtëpia deri në venddepozitimin më të afërt të miratuar nga Bashkia, duke e shoqëruar me investimin për vendosjen e kontenierëve të diferencuar për mbetjet që në burim (letër, plastikë, qelq dhe mbetje të njoma), si dhe marrjen e masave për të siguruar që kontenierët të qëndrojnë të mbyllur, kur nuk janë në përdorim.
3. Rritja e shpeshtësisë të mbledhjes së mbetjeve në venddepozitime, që të shmangët kthimi i tyre në zona të rrezikshme për jetën e banorëve përreth.
4. Organizimi i fushatave të organizuara të ndërgjegjësimit për rritjen e informacionit të qytetarëve mbi uljen e gjenerimit të mbetjeve shtëpiake, rëndësinë e hedhjes së mbetjeve në venddepozitimet e përcaktuara dhe diferencimin e tyre, duke targetuar veçanërisht gratë, duke qënë se rezulton që janë ato

që merren më së shumti me mbetjet që gjenerohen në shtëpi, si rezultat i nivelit shumë të lartë të papunësisë së tyre (57%) e evidentuar në zonën e Ish-Kënetës¹.

Transportimi

1. Modernizimi i teknologjisë për evadimin dhe trajtimin e mbetjeve urbane me makina të reja grumbullimi të mbetjeve, autofshesa, fadroma, eskavator, autoagregat, kamione etj., në mënyrë që të rritet cilësia e shërbimit, të ulët koha e nevojshme për evadimin dhe trajtimin, si edhe të ulen kostot e mirëmbajtjes (vajra, filtra, goma etj).
2. Formalizimi dhe integrimi i individëve / operatorëve informalë mbledhës të mbeturinave në strategjitë lokale për manaxhimin e mbetjeve.

Përpunimi

1. Mbështetja e krijimit të subjekteve për evadimin dhe trajtimin e mbetjeve, si dhe realizimi i proceseve të transportimit, përpunimit dhe asgjësimit përmes partneritetit publik-privat.
2. Investimi në impiante (inceneratorë) për trajtimin e mbetjeve urbane dhe industriale duke i shndërruar ato në energji.


Asgjësimi

1. Ndalimi i vendgrumbullimeve të hapura, ku mbetjet lihen të dekompozohen nga proceset natyrore dhe faktori kohë.

¹ "Vlerësimi i situatës së papunësisë gjinore në zonën migratore të Ish-Kënetës Durrës" studim i Qendrës për Zhvillim Komunitar "Sot për të Ardhmen", financuar nga OSFA - Fondacioni "Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", Dhjetor 2015



Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian apo dhe të REC Shqipëri





Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

BASHKIMI EVROPIAN
DELEGACIONI NË SHQIPËRI

ACHIEVE

shoqëria civile shqiptare për një mjedis evropian



REC

Shqipëri

SOT PËR TË ARDHMEN

Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” është një organizatë lider në Shqipëri për mobilizim dhe fuqizim të komuniteteve në nevojë. E udhëhequr nga vizioni i organizatës “Sot për të Ardhmen” dhe duke përdorur metoda inovative dhe gjithëpërfshirëse, QZHK “Sot për të Ardhmen” ka krijuar përqasje të suksesshme të fuqizimit gjinor; vullnetarizmit; aktivizmit; mbrojtjes së mjedisit; ndërmjetësimit për punësim; shërbimeve, përfshirjes dhe mobilizimit komunitar.

QZHK “Sot për të Ardhmen” - Durrës
L.17, Rr. “Rinia Durrsake, Skolina 5, ish-Kënetë, Durrës, Shqipëri
Kutia Postare (POBOX) 537 / Tel/Fax +355 52 90 10 71 /
Tel: +355 52 90 10 70 / +355 42 30 24 10

e-mail: info@cdc-tff.org



 www.facebook.com/AlbanianCommunityCentre

 www.youtube.com/SotPerTeArdhmen

 www.twitter.com/SotPerTeArdhmen

 www.cdc-tff.org

